

Tiranë më 08/09/2022

AKT-THEMELIMI

**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“City News Albania”**

Elvi Fundo, i biri i Emil-it , i datelindjes 03/03/1977, lindur ne Korçë dhe banues ne Tirane, ne adresen Rruga Asim Vokshi, Identifikuar nepermjet ID H70303054N, shtetas shqiptar, madhor e me zotesi te plote per te vepruar si dhe Subjekti CNA Media sh.p.k Identifikuar ne QKB me NIPT L72011012I me seli qendrore ne "Rruga Selita e Vjetër, Përballë derës së Kopshtit Botanik, Zona Kadastrale 8270, Tiranë" perfaqesuar nga Administratorja Zj/ Etleva Skonja Në bazë të ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", (i ndryshuar); ligjit 9901 datë 14.04. 2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), Kodit Civil në fuqi, ligjit "Për QKB-në", Kodit Doganor, Fiskal e Tatimor, me vullnet të lirë e të plotë vendos:

**Neni 1**

Te themeloje nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar per te ushtruar veprimtarine ekonomike, e emertuar **“City News Albania”**.

**Neni 2**

Shoqeria do te jete e formes se Shoqerive Tregtare me Pergjegjesi Te Kufizuar dhe perballon humbjet sipas ligjeve ne fuqi.

**Neni 3**

Shoqeria e ka seline e saj ne Rruga Selita e Vjetër, Përballë derës së Kopshtit Botanik, Zona Kadastrale 8270, Tiranë  
Ajo ka te drejte te krijoje brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise, filjale, agjensi perfaqesimi, seli sekondare si dhe ti suprimoje ato.

**Neni 4**

Shoqeria do te kete nje kohezgjatje me kufi te pacaktuar dhe mund te shperbehet ne cdo kohe me vendim te Ortakut te Vetem.

**Neni 5**

Kapitali fillestar i shoqërisë është 20'000'000 (njëzetmillion) Lekë, pronë e ortakeve te shoqerise.

Kapitali përbëhet nga 2 (dy) kuota, me vlerë 20'000'000 (njëzetmilion) Lekë.

Ato ndahen:

Z/ Elvi Fundo, Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë 16'000'000 (gjashtëmbëdhjetëmilion) Lekë, perkatesisht 80% te aksioneve.

CNA Media, Zoteruese e 1 (një) kuote me vlerë 4'000'000 (katërmilion) Lekë, perkatesisht 20% te aksioneve

Kapitali mund te ndryshoje vetem me vendim te ortakeve.

#### **Neni 6**

Ne librin e llogarise se shoqerise do te krijohet "Fondi Themelor i Ortakeve". Rritja e kapitalit te ortakut nuk eshte e kufizuar.

#### **Neni 7**

Te gjitha pjeset e kapitalit themelor jane teresisht te shlyeshme dhe te nenshkrueshme nga ortaket e shoqerise.

#### **Neni 8**

Objekti I aktivitetit ekonomik te shoqerise do te jete:

*Ushtrim i Veprimtarisë në fushën Audiovizive.*

#### **Neni 9**

Marredheniet e punesimit ne shoqeri do te rregullohen nepermjet Kontrates se Punesimit qe lidhet midis paleve ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 7961 date 12.07.1995 (Kodi i Punes), si dhe akteve te tjera nenligjore te dala ne zbatim te tij.

#### **Neni 10**

Shoqeria gjate ushtrimit te aktivitetit te saj mund te zmadhoje ose te zvogeloje kapitalin themelor, ne baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

#### **Neni 11**

Shoqeria vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejta dhe detyrime vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaket themelues mbartin rrezikun e veprimtarise se shoqerise vetem ne nivelin e kapitalit themeltar te investuar ne shoqeri.

## Neni 12

Mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, midis punonjesve te saj, si dhe me te tretet, kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, ceshtja mbetet ne kompetence te Gjykates.

## Neni 13

Shoqeria do te kete vulen e saj ku jane percaktuar emri dhe inicialet e formes se saj ligjore.

## Neni 14

Pasuria e Shoqerise mund te sigurohet prane Shoqerive te Sigurimeve.

## Neni 15

Shoqeria e pushon aktivitetin e saj me mbarimin e afatit te percaktuar ne kete kontrate ose per shkaqe te perligjura qe gjykohen te tilla nga ortaku.

## Neni 16

Organet e shoqerise "**City News Albania**" sh.p.k, jane:

- Ortaket e shoqerise.
- Administratori i shoqerise.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit te tyre do te percaktohen ne Statutin e Shoqerise. Administrator i shoqerise eshte **Zj. Etleva Skonja** me ID **H75721123P**, e bija e Dilaverit, e datelindjes 21/07/1977, lindur ne Burrel dhe banuese ne Durres, ne adresen Rruga "Abdyl Ypi". Modalitetet per ndryshimin e Administratorit si dhe kompetencat e tij rregullohen nga Statuti i Shoqerise dhe Ligji Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

## ORTAKET THEMELUES

Elvi Fundo  


**CNA MEDIA**

Administratore  
Etleva Skonja  


